



**VENDIM**

**Nr. 68 Datë 11.05.2015**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIM IMPIANTI  
PRODHUES SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE TË  
SHOQËRISË "GAMA ENERGY" SH.P.K., PËR HEC "LENA 1", "LENA  
2" DHE "LENA 2A" PËRKATËSISHT ME FUQI 1.95 MW; 2.3 MW DHE  
0.25 MW ( FUQI TOTALE 4.5 MW).**

Në mbështetje nenit 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", të ndryshuar, nenit 8 të "*Rregullores së Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme*", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "**GAMA ENERGY**" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikim impianti prodhues si burim i rinovueshëm energjie për HEC "Lena 1", "Lena 2" dhe "Lena 2A".

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë "GAMA ENERGY" sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "*Rregulloren e Procedurave të Çertifikimit dhe të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme*", si më poshtë:

- Eshte dhene informacioni i kerkuar lidhur me klasikimin e impiantit te ndertuar.
- Eshte paraqitur raporti teknik, i cili pershkruan hollesisht teknologjine gjeneruese qe do te perdoret ne impiantin e siperpermendur.
- Eshte paraqitur dokumentacioni teknik, i cili pershkruan karakteristikat baze te te gjithë elementeve te impiantit prodhues.
- Jane paraqitur skicat e projektit te zbatimit.
- Nuk eshte paraqitur harta Korografike e impiantit

Per dokumentacionet e munguara, do te njoftohet subjekti qe ne baze te "*Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit te Plote/te Pjesshem dhe*

*Rinovimit te Licensave*”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqese keto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për kualifikim impianti prodhues te shoqerise “GAMA ENERGY” sh.p.k.,si burim i rinovueshem energjie nga Hec “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**